

AKT THEMELIMI

i Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar
"OHAYAN"sh.p.k.

Sot, me date 01.08.2024, u paraqiten personalisht :

1) Marjeta Gjergji ,atesia Ded, amesia Dilë, shtetas Shqiptar, lindur ne Dom dhe banues ne Kamez , ne Rugen SKENDERBEU me 26.01.1993 me Leternjoftim ID nr 034690188 Nr. personal J35126042P, leshuar date 28.08.2019 nga MPB,

periplohet ky Akti Themelimi si vijon:

Neni 1 ORTAKET THEMELUES

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar **"OHAYAN"sh.p.k** themelohet nga ortakët

1) Marjeta Gjergji ,atesia Ded, amesia Dilë, shtetas Shqiptar, lindur ne Dom dhe banues ne Kamez , ne Rugen SKENDERBEU me 26.01.1993 me Leternjoftim ID nr 034690188 Nr. personal J35126042P, leshuar date 28.08.2019 nga MPB,

Neni 2 PERSONALITETI JURIDIK

Shoqeria **"OHAYAN"sh.p.k** do te jete person juridik shqiptar. Kjo do ta fitoje personalitetin juridik kur te regjistrohet prane Qendres Kombetare te Biznesit te Shoqerive Tregtare, ndersa veprimtarine ekonomike do ta filloje pasi te pajiset me lejen perkatese nga organet kompetente.

Veprimtaria e Shoqerise do te rregullohet sipas dispozitave te ketij akti themelimi, Statutit bashkalidhur dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Neni 3 SELIA

Shoqeria **"OHAYAN"sh.p.k** do ta kete seline ne Republiken e Shqiperise,
"Ruga Skenderbeu Nr 2, Zone Kadastrale Nr 2066, Nr Pasurie 89/71+3-
N28, Kamez

Veprimtaria e shoqerise do te vazhdoje per afat kohor te pacaktuar.

Neni 4 OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarise te Shoqerise **"OHAYAN"sh.p.k** Sh.p.k do te jete :

- ✓ Shit -blerie te veshjeve, aksesoreve, kepuceve.
- ✓ Import
- ✓ Dhenie me qera e tyre

Neni 5 KAPITALI THEMELTAR

Kapitali i shoqerise perbehet vetem nga kontributi ne para, ne shumen 1.000.000(njemilion) leke.

1. Ortaku themelues Marjeta Gjergji: zoterues i 1 (nje) kuote me vlere 1.000.000(njemilion)leke qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise;

Neni 6
FONDET E SHOQERISE

Shoqeria do te krijojë fondet perkatese, te cilat do te specifikohen ne Statutin e Shoqerise dhe do te mbahen ne Librin e caktuar per kete qellim.

Neni 7
NDARJA E FITIMIT TE SHOQERISE

Fitimi neto qe do te realizohet nga shoqeria, d.m.th. qe do te mbetet pas shlyerjes te te gjitha detyrimeve dhe pas vecimit te fondeve te detyruara, do t'i kaloje ortakeve.

Neni 8
PERGJEGJESITE E ORTAKEVE

Ortaket jane pergjegjes kundrejt te treteve per pasojat dhe demet qe rrjedhin nga anulimi ose deklarimi i pavlefshem i aktit te themelimit te shoqerise.

Po ashtu, ortaket jane pergjegjes ne masen 100 % edhe per te gjitha humbjet qe mund te rezultojne gjate aktivitetit ekonomik te shoqerise.

Neni 9
DISPOZITE E PERGJITHESHME

Problemet e kapitalit themeltar dhe te pjeseve nominative, transferimi i kapitalit, zmadhimi dhe zvoglimi i kapitalit, menyra e administrimit te shoqerise, emerimi i administratoreve dhe eksperteve kontabel te autorizuar, kompetencat dhe pergjegjesite e tyre, menyra e mbajtjes se llogarive, falimentimi dhe humbja e kapitalit themeltar, shnderrimi i shoqerise, zgjidhja e mosmarrveshjeve dhe problemet e tjera qe lidhen me veprimtarine e shoqerise do te zgjidhen sipas dispozitave te Statutit te Shoqerise dhe, ne mungese te tyre, nga legjislacioni ne fuqi.

Ky akt themelimi, u hartua ne baze te vullnetit te lire te ortakeve, hartohet ne 3 ekzemplare.

Per sa me siper ju lexua me ze te larte dhe te qarte ortakeve dhe meqense ajo shpreh vullnetin e tyre, neneshkruhet pa verejtje.

ORTAKET E SHOQERISE